

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
SHOQËRIA AKSIONARE
“BANKA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT” SH.A.

KREU I

(THEMELIMI - OBJEKTIVI DHE PARIMET- BURIMET FINANCIARE DHELLOGARITE E DEDIKUARA)

Neni 1

Themelimi

Sot, me datë 16.12 2025, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 23/2025, datë 17.3.2025 “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit”, të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 343, datë 19.6.2025, “Për caktimin e Ministrisë së Financave si përfaqësuese të Shtetit Shqiptar në cilësinë e aksionarit të parë të shoqërisë ‘Banka Shqiptare e Zhvillimit’ Sh.A.”, themelohet shoqëria aksionare “Banka Shqiptare e Zhvillimit” Sh.A.

Neni 2

Objektivi dhe Parimet

- 2.1 Banka Shqiptare e Zhvillimit Sh.A ka për objektiv kryesor nxitjen e zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor të vendit, në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit për ndihmën shtetërore. Në këtë kuadër, Banka Shqiptare e Zhvillimit Sh.A synon të lehtësojë qasjen në financë, kryesisht përmes financimit dhe mbështetjes së sipërmarrjeve në sektorët e nënfinancuar të ekonomisë, si dhe përfshirje në sistemin financiar të individëve të cilëve nuk u ofrohen shërbime të plota nga sistemi bankar.
- 2.2 Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Banka Shqiptare e Zhvillimit Sh.A, udhëhiqet nga këto parime:
- a. mbështetja e zhvillimit ekonomik e social nëpërmjet lehtësimit të qasjes në financa dhe përmirësimit të kushteve për sektorët strategjikë të ekonomisë;
 - b. promovimi i partneriteteve dhe i bashkëpunimit me institucione financiare kombëtare e ndërkombëtare për të mbështetur investimet dhe rritjen ekonomike;
 - c. promovimi i interesit publik, duke mbështetur projekte me ndikim afatgjatë në zhvillimin ekonomik e social të vendit;
 - d. qëndrueshmëria dhe ekuilibri financiar;
 - e. transparenca dhe llogaridhënia, duke siguruar menaxhim të përgjegjshëm e të hapur të fondeve dhe burimeve financiare;

- f. përputhshmëria me politikat dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të monitorimit dhe menaxhimit të riskut financiar;
- g. pavarësia operationale dhe garantimi i vendimmarrjes së paanshme, në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore;
- h. ndarja e qartë e aktiviteteve promovuese dhe tregtare, duke shmangur çdo formë subvencionimi të ndërsjellë mes këtyre aktiviteteve;
- i. përputhshmëria me standardet financiare dhe ligjore nëpërmjet ndarjes së sistemeve financiare dhe të raportimit.

Neni 3

Burimet financiare dhe llogaritë e dedikuara

- 3.1 Burimet financiare të Bankës sigurohen nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, përfshirë:
 - a. linjat e kredisë nga institucionet financiare ndërkombëtare;
 - b. pranimi i fondeve të kthyeshme nga publiku, veçanërisht nga individët që nuk u ofrohet shërbim i plotë nga sistemi bankar, në formën e produkteve të kursimit, nëpërmjet një entiteti të veçantë të Postës Shqiptare sh.a. Shuma e pranuar e këtyre fondeve nga Banka do të jetë në përputhje me përqindjet e përcaktuara në Ligjin nr. 23/2025, datë 17.3.2025 “*Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit*”. Produktet e kursimit të mbledhura nga publiku garantohen me garanci shtetërore dhe përdoren për aktivitete promovuese;
 - c. instrumente të tjera financiare të garantuara, rast pas rasti, me garanci shtetërore, duke respektuar parimet e përcaktuara në ligjin që rregullon huamarrjen shtetërore. Emetimi i titujve të garantuar me garanci shtetërore nuk u nënshtrohet parashikimeve të ligjit që rregullon tregjet e kapitalit;
 - d. burime të tjera financimi.
- 3.2 Pranimi dhe administrimi i fondeve të kthyeshme nga publiku dhe i instrumenteve të garantuara nga shteti i nënshtrohen kërkesave për qëndrueshmëri financiare dhe menaxhim të rrezikut të përcaktuara në nenin 8 të këtij Statuti.
- 3.3 Në zbatim të nenit 20, pika 2), shkronja ç) të Ligjit nr. 23., datë 17.3.2025 “*Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit*”, do të vendoset një ndarje e qartë e llogarive, të dhënave dhe regjistrimeve financiare, si dhe e sistemeve të raportimit për aktivitetet promovuese dhe ato tregtare, administrimi i të cilave do të jetë në përputhje me kriteret e transparencës dhe garantimit të ekuilibrit ekonomik për arritjen e objektivave të përcaktuara në nenin 8 të këtij Statuti.

KREU II

(EMËRTIMI – FORMA JURIDIKE – SELIA – KOHËZGJATJA -OBJEKTI)

Neni 4

Emërtimi

Shoqëria emërtohet “**Banka Shqiptare e Zhvillimit**” Sh.A dhe me emrin e shkurtuar “**BZH**” (ne vijim e tutje quajtur si “**Banka Shqiptare e Zhvillimit**” Sh.A” ose “**Banka**”), dhe emërtimi në gjuhën angleze është “**Albanian Development Bank**”.

Neni 5

Forma juridike

Banka Shqiptare e Zhvillimit Sh.A ka formën e Shoqërisë Aksionare, e themeluar dhe e organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, përkatësisht me dispozitat e ligjit nr. 23., datë 17.3.2025 “*Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit*”, dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*” të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 19.6.2025, “*Për caktimin e Ministrisë së Financave si përfaqësuese të Shtetit Shqiptar në cilësinë e aksionarit të parë të shoqërisë ‘Banka Shqiptare e Zhvillimit’ Sh.A*” dhe në përputhje me këtë akt.

Neni 6

Selia, stema dhe vula

- 6.1 Selia e Bankës do të jetë në adresën: *Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 3, 1001, Tiranë.*
- 6.2 Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve mund të krijojë dhe/ose të mbyllë filiale, degë, agjenci dhe/ose zyra përfaqësimi, në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.
- 6.3 Banka fiton personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin e Biznesit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri.
- 6.4 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve përcakton stemën dhe vulën e Bankës.

Neni 7

Kohëzgjatja

- 7.1 Banka do të ushtrrojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pakufizuar, që do të fillojë nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin e Biznesit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 7.2 Prishja dhe likuidimi i Bankës do të përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe të legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Objekti i veprimtarisë

8.1 Banka ushtron veprimtaritë e mëposhtme:

8.1.1 financimin me karakter promovues:

- (i) kredidhënia për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe *startup-et* vendase për të nxitur rritjen, produktivitetin, konkurrueshmërinë dhe zgjerimin në tregjet ndërkombëtare;
- (ii) kredidhënia dhe mbështetja për eksportet e mallrave dhe shërbimeve vendase;
- (iii) kredidhënia për projektet publike në nivel qendror e vendor, me përparësi për ekonominë e vendit;
- (iv) kredidhënia për zhvillimin, përmirësimin e modernizimin e infrastrukturës fizike dhe digjitale të vendit, në përputhje me objektivat strategjike kombëtare;

8.1.2 kredidhënien për shoqëritë tregtare vendase bazuar në kushtet e tregut dhe në parimet e konkurrencës së lirë, si veprimtari plotësuese e financimit të ofruar nga bankat tregtare.

8.2 Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, ndër të tjera, Banka:

8.2.1 Në aspektin e aktiveve dhe/ose investimeve mund të:

- (i) akordojë kredi afatshkurtra dhe afatmesme-afatgjata për persona juridikë të tretë, qoftë drejtpërdrejt ose përmes marrëveshjeve të bashkëfinancimit në bashkëpunim me institucionet financiare vendase dhe ndërkombëtare;
- (ii) lëshojë garanci financiare dhe tregtare afatshkurtra dhe afatgjata;
- (iii) blejë obligacione të korporatave;
- (iv) marrë pjesë në instrumente financiare të kapitalit dhe instrumente të tjera të ngjashme;
- (v) investojë tepriçën e likuiditetit në obligacione qeveritare vendase dhe ndërkombëtare;
- (vi) hapë llogari rrjedhëse në banka tregtare dhe ndërkombëtare;
- (vii) vendosë depozita afatshkurtra dhe afatmesme në banka tregtare;
- (viii) veprojnë si agjent për administrimin e granteve kombëtare në përputhje me vendimet e Këshillit të Ministrave dhe për çdo skemë tjetër grantesh.

8.2.2 Në aspektin e financimit dhe/ose detyrimeve mund të:

- (i) emetojnë obligacione afatshkurtra dhe afatmesme-afatgjata në tregjet financiare vendase dhe ndërkombëtare;
- (ii) pranojnë depozita afatshkurtra dhe afatmesme nga bankat tregtare dhe institucionet e tjera financiare vendase dhe ndërkombëtare;
- (iii) ketë akses në operacionet e politikës monetare me Bankën e Shqipërisë dhe në operacionet e rifinancimit me bankat dhe institucionet financiare vendase dhe ndërkombëtare;

- (iv) marrë dhe administrojë fonde strukturore nga shteti dhe/ose institucionet supranacionale;
- (v) pranojë fonde të kthyeshme nga publiku, veçanërisht nga individët që nuk u ofrohet shërbim i plotë nga sistemi bankar, në formën e produkteve të kursimit, nëpërmjet një entiteti të veçantë të Postës Shqiptare sh.a. Produktet e kursimit të mbledhura nga publiku garantohen me garanci shtetërore dhe përdoren për aktivitete promovuese.

8.3 Banka kryen, në kushte tregu dhe bazuar në parimet e konkurrencës, drejtpërdrejt ose nëpërmjet shoqërive apo degëve të saj çdo aktivitet ndihmës, përfshirë financimin e kapitalit privat dhe mbajtjen e aksioneve në shoqëri me qëndrueshmëri financiare.

8.4 Të gjitha veprimtaritë e kryera të huadhënies do të udhëhiqen nga parimet e bashkëpunimit dhe plotësueshmërisë, duke shmangur efektet e zhvendosjes (*crowd-out*) dhe duke synuar të tërheqin (*crowd-in*) aktorë të tregut, investitorë ose institucione të tjera.

8.5 Banka do të kryejë operacionet e saj në një mënyrë të ligjshme, të kujdesshme dhe efikase për të siguruar qëndrueshmëri financiare afatgjatë. Ajo do të menaxhojë burimet dhe rreziqet e saj në mënyrë të përgjegjshme për të mbuluar kostot e saj operative dhe për të ruajtur nivele të mjaftueshme të kapitalit dhe likuiditetit të nevojshëm për të përmbushur në mënyrë efektive mandatin e saj.

8.6 Banka mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të lejueshme që është e nevojshme dhe e dobishme për të përmbushur objektin e veprimtarisë së saj.

KREU III

(KAPITALI I REGJISTRUAR DHE AKSIONET – ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT- TRANSFERIMI I KAPITALIT- REZERVA LIGJORE)

Neni 9

Kapitali aksionar i regjistruar

9.1 Kapitali fillestar i Bankës i nënshkruar nga shteti shqiptar, është 10 000 000 000 (dhjetë miliardë) lekë.

9.2 Kapitali fillestar shlyhet në këste brenda një afati 4-vjeçar. Kësti i parë i kapitalit aksionar është 1 000 000 000 (një miliard) lekë dhe do të shlyhet brenda vitit 2026. Këstet e mbetura do të shlyhet në afatet si vijon:

- (i) 2.000 000 000 do të shlyhet brenda vitit 2027
- (ii) 3.000 000 000 do të shlyhet brenda vitit 2028
- (iii) 4.000 000 000 do të shlyhet brenda vitit 2029

Kapitali fillestar i Bankës ndahet në 5 milionë aksione të zakonshme, secila me vlerë nominale prej 2000 lekësh.

9.3 Çdo aksionar i ri i Bankës është i detyruar të nënshkruajë dhe të shlyejë tërësisht pjesën përkatëse të kapitalit të regjistruar, kur ai fiton ose kur i kalohen aksionet e Bankës në emër të tij, në përputhje me dispozitat e legjislacionit të zbatueshëm.

9.4 Rregullat mbi regjistrimin, transferimin dhe kufizimet mbi aksionet përcaktohen nga legjislacioni në fuqi dhe nga ky Statut.

Neni 10

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i Bankës mund të zmadhohet ose zvogëlohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare.

Neni 11

Transferimi i Aksioneve

11.1 Me përjashtim të aksioneve të mbajtura nga shteti shqiptar, të cilat nuk mund të transferohen dhe të disponohen në asnjë mënyrë tjetër, aksionet e tjera të Bankës janë të transferueshme lirshëm në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi; megjithatë, me kusht që (i) pranimi i çdo aksionari të ri të jetë i kushtëzuar me përmbushjen e kritereve të përcaktuara nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave dhe, (ii) asnjë aksionar, përveç shtetit shqiptar të mos zotërojë më shumë se 10% (dhjetë përqind) të aksioneve të Bankës.

11.2 Shteti shqiptar mban gjithmonë jo më pak se 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit të regjistruar të Bankës. Aksionet e mbajtura nga shteti shqiptar, të nevojshme për të ruajtur këtë pjesëmarrje, janë të patransferueshme dhe nuk mund të tjetërsohen në asnjë formë.

11.3 Për qindja e zotërimit të aksioneve sipas pikës 11.1 të këtij neni llogaritet duke përfshirë edhe zotërimet e shoqërisë mëmë/holding, të shoqërive bija të zotëruara drejtpërdrejt ose tërthorazi, si dhe të shoqërive të lidhura.

Neni 12

Rezerva Ligjore

12.1 Banka, nga fitimi neto i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, pas zbritjes së shpenzimeve, detyrohet të kalojë në rezervën ligjore jo më pak se 5% (pesë për qind) të kësaj vlere, derisa shuma e rezervës ligjore të arrijë 10% (dhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar.

12.2 Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, mund të vendosë krijimin e rezervave të tjera statutores ose të veçanta, sipas kërkesave rregullore dhe nevojave të Bankës, të cilat përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në vendimin përkatës.

12.3 Banka mund të llogarisë dhe të ndajë dividendë vetëm pasi nga fitimi vjetor të jenë zbritur shumatat e destinuarat për rezervën ligjore dhe për rezervat e tjera të krijuara sipas këtij Statuti ose legjislacionit në fuqi.

KREU IV
(STRUKTURA E AKSIONAREVE TE BANKES – KOMPETENCAT- REGJISTRI I
AKSIONEVE – REGJISTRI I VENDIMEVE)

Neni 13

Struktura e Aksionareve te Bankës

- 13.1 Aksionari i parë i shoqërisë “**Banka Shqiptare e Zhvillimit**” Sh.A, është shteti shqiptar i përfaqësuar nga Ministria e Financave me NIPT K02231002H.
- 13.2 Përveç shtetit shqiptar, aksionarë në Bankën Shqiptare të Zhvillimit Sh.A, mund të jenë institucione financiare ndërkombëtare dhe vendase të njohura, pjesëmarrja e se cilëve ne përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
- 13.3 Shteti shqiptar mban gjithmonë jo më pak se 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit të regjistruar të Bankës. Aksionet e mbajtura nga shteti shqiptar, të nevojshme për të ruajtur këtë pjesëmarrje, janë të patransferueshme dhe nuk mund të tjetërsohen në asnjë formë.
- 13.4 Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme te Aksionareve ushtrohen nga Ministria e Financave, për aq kohë që shteti shqiptar është Aksionari i Vetëm i Bankës.

Neni 14

Kompetencat

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve shërben si organi më i lartë vendimmarrës i Bankës Shqiptare të Zhvillimit Sh.A.
- 14.2 Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve është përgjegjëse, ndër të tjera, për vendime në lidhje me çështjet e mëposhtme:
- a. të miratojë Statutin dhe ndryshimet e tij;
 - b. të përcaktojë objektivat dhe qëllimet strategjike të përgjithshme;
 - c. të miratojë raportet vjetore dhe pasqyrat financiare;
 - d. të emërojë dhe të shkarkojë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës;
 - e. të emërojë dhe të shkarkojë anëtarët e Komitetit të Kontrollit;
 - f. të emërojë dhe të shkarkojë audituesin ligjor të jashtëm;
 - g. të miratojë skemën e pagave për Këshillin Mbikëqyrës dhe Komitetin e Kontrollit;
 - h. të miratojë dhe mbikëqyrë procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, duke garantuar përputhshmëri me këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi;
 - i. të miratojë një rregullore të posaçme që përcakton procedurat e përzgjedhjes, duke përfshirë kriteret e përshtatshmërisë, integritetit, pavarësisë dhe kualifikimeve profesionale të kandidatëve;

j. çdo çështje tjetër të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm ose ky Statut.

Neni 15

Regjistri i Aksioneve

- 15.1 Banka mban një regjistër të posaçëm të aksioneve, në të cilin regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve, përfshirë: emrin dhe mbiemrin e aksionarit, ose emrin e regjistruar në rastin kur aksionari është person juridik; vlerën nominale të aksionit; adresën e banimit ose selinë qendrore të aksionarit; si dhe datën e kryerjes së regjistrimit.
- 15.2 Personat e regjistruar sipas pikës 15.1 të këtij neni prezumohen si aksionarë të Bankës me të drejta të plota, si në marrëdhëniet me Bankën, ashtu edhe në marrëdhëniet me palët e treta.
- 15.3 Administratori i Përgjithshëm është përgjegjës për mbajtjen e saktë dhe të përditësuar të regjistrit të aksioneve të Bankës dhe janë të detyruar të lejojnë akses në informacionin e regjistrit për çdo aksionar ose person tjetër që e kërkon në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 16

Regjistri i Vendimeve

- 16.1 Të gjitha vendimet e Aksionarit të Vetëm duhet të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, përmbajtja të cilit nuk duhet të fshihet apo të modifikohet. Në veçanti, duhet të regjistrohen vendimet që kanë të bëjnë me:
- (i) miratimin e pasqyrave financiare dhe raportit mbi ecurinë e veprimtarisë së Bankës;
 - (ii) shpërndarjen e fitimeve dhe humbjeve;
 - (iii) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;
 - (iv) vendime në lidhje me investimet;
 - (v) riorganizimin dhe prishjen e Bankës.
- 16.2 Lista e vendimeve me lart nuk konsiderohet shteruese, dhe çdo vendim që nuk është i regjistruar në Regjistrin e Vendimeve do të konsiderohet i pavlefshëm.

KREU V

(MBLEDHJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE – THIRRJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE – KUORUMI DHE MARRJA E VENDIMEVE)

Neni 17

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve

- 17.1 Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve thirret të paktën 1 (një) herë në vit. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve thirret gjithashtu në të gjitha rastet e parashikuara nga legjislacioni i zbatueshëm, si dhe sa herë që një mbledhje e tillë konsiderohet e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Bankës.
- 17.2 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni i zbatueshëm, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, si rregull i përgjithshëm, thirret nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës.
- 17.3 Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e Bankës nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vijim.
- 17.4 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve duhet të thirret kur Banka propozon të shesë apo të disponojë aktive të cilat kanë një vlerë më të madhe se 5% (pesë për qind) e totalit të aktiveve të Bankës, siç rezulton në pasqyrat financiare të fundit të certifikuara.
- 17.5 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve duhet të thirret gjithashtu kur Banka, brenda 2 (dy) viteve të para nga regjistrimi i saj, propozon të blejë nga një aksionar pasuri me vlerë më të madhe se 5% (pesë për qind) e totalit të aktiveve të Bankës, siç rezulton në pasqyrat financiare të fundit të certifikuara.
- 17.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve mund të mbahen edhe përmes audio ose video-konferencës, me kusht që:
- Kryetari dhe sekretari i mbledhjes, i caktuar nga kryetari nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, të jenë të pranishëm në të njëjtin vend dhe të përkujdesen për hartimin dhe nënshkrimin e procesverbalit, duke u konsideruar se mbledhja është zhvilluar në atë vend;
 - t'i mundësohet kryetarit të mbledhjes dhe sekretarit të verifikojnë identitetin e pjesëmarrësve, të drejtojnë zhvillimin e mbledhjes dhe të konstatojnë e shpallin rezultatet e votimit;
 - t'i mundësohet sekretarit që harton procesverbalin të ndjekë në mënyrë të përshtatshme zhvillimin e mbledhjes që përshkruhet në procesverbal;
 - pjesëmarrësve t'u mundësohet të marrin pjesë në diskutim dhe në votimin njëkohësisht për çështjet në rendin e ditës, si dhe të shohin, marrin ose dërgojnë dokumente.

Neni 18

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve

- 18.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve thirret me anë të një njoftimi me shkrim të dërguar në adresën e treguar në Regjistrin e Aksionarëve. Njoftimi, së bashku me rendin e ditës, duhet t'u dërgohet të gjithë aksionarëve jo më vonë se 21 (njëzet e një) ditë para datës së planifikuar të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

18.2 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve duhet të përfshijë, minimalisht, informacionin e mëposhtëm:

- a. Emrin e plotë të Bankës, selinë e saj të regjistruar dhe vendin, datën dhe orën e mbledhjes;
- b. Një shpjegim të detajuar të procedurave që duhet të ndjekin aksionarët për të marrë pjesë dhe për të votuar në mbledhje, duke përfshirë:
 - i. Të drejtat e aksionarëve të pakicës që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të totalit të aksioneve, sipas legjislacionit të zbatueshëm;
 - ii. Procedurat për votimin me autorizim;
 - iii. Procedurat për votimin me mjete elektronike;
- c. Informacion mbi vendndodhjen (adresën) dhe mënyrat përmes të cilave aksionarët mund të marrin, në formë të plotë, dokumentet dhe projektvendimet që do t'i paraqiten asamblesë për shqyrtim.

18.3 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, së bashku me rendin e ditës, publikohet gjithashtu në faqen zyrtare të Bankës në internet.

Neni 19

Kuorumi dhe marrja e vendimeve

19.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund të marrë vendime të vlefshme për çështjet që vendosen me shumicë të thjeshtë, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarë që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të aksioneve me të drejtë vote.

19.2 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund të marrë vendime të vlefshme për çështjet që kërkojnë shumicë të kualifikuar, vetëm nëse në votim marrin pjesë aksionarë që zotërojnë më shumë se një të dytën ($\frac{1}{2}$) e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, duke votuar personalisht ose me mjete elektronike.

19.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të kërkuar, ajo thirret sërish jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë më pas, duke ruajtur të njëjtin rend dite.

19.4 Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, me kuorumin e përcaktuar në pikën 19.2 të këtij neni, miraton vendime për çështjet që kërkojnë shumicë të kualifikuar me të paktën tre të katërtat ($\frac{3}{4}$) e votave të aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje. Çështjet që kërkojnë shumicë të kualifikuar përfshijnë:

- a. Ndryshimet në Statut;
- b. Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar; dhe
- c. Shpërndarjen e fitimeve;

19.5 Me përjashtim të çështjeve të përcaktuara në pikën 19.4 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme të Aksionarëve, e mbledhur me kuorumin e përcaktuar në pikën 19.1 të këtij neni, merr vendime për çështjet e tjera me shumicën e votave të aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje.

KREU VI

(KËSHILLI MBIKËQYRËS – PËRBËRJA- ROLI DHE PËRGJEGJËSITË –MBLEDHJET)

Neni 20

Këshilli Mbikëqyrës

20.1 Këshilli Mbikëqyrës është organi përgjegjës për mbikëqyrjen e politikave tregtare dhe administrimin e përgjithshëm të Bankës. Ai siguron përputhshmërinë e veprimtarisë së Bankës me Statutin, kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbështet ruajtjen e stabilitetit financiar dhe arritjen e objektivave afatgjatë të Bankës.

20.2 Struktura dhe përbërja e Këshillit Mbikëqyrës pasqyron një përfaqësim të balancuar të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë shqiptare. Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve në vendimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës përcakton sektorët e ekonomisë që përfaqësohen në Këshillin Mbikëqyrës.

Neni 21

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës

21.1 Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga një numër tek anëtarësh, jo më pak se 5 (pesë) dhe jo më shumë se 9 (nëntë) anëtarë. Shumica e anëtarëve të Këshillit, përfshirë Kryetarin, janë anëtarë të pavarur në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe të këtij Statuti.

21.2 Në përputhje me nenin 115 të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, anëtarët e parë të Këshillit Mbikëqyrës janë:

- (i) Znj. Irida Huta, shtetase shqiptare, e lindur më 01.09.1976 në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal H65901157O;
- (ii) Z. Arben Shkodra, shtetas shqiptar, i lindur më 17.07.1973 në Krujë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H30714147L;
- (iii) Znj. Eris Hysi, shtetase shqiptare, e lindur më 28.05.1970 në Rrëshen, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal H95528223O;
- (iv) Z. Artur Asllani, shtetas shqiptar, i lindur më 12.08.1973 në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H30812127J;

- (v) Z. Daniel, Marc Demeulenaere, shtetas francez, i lindur më 30.03.1978, në Clamart, Francë, mbajtës i pasaportës me numër 25DA24980.

- 21.3 Këshilli Mbikëqyrës qëndron në detyrë për një periudhë prej 3 (tre) vitesh, me te drejte ripërtëritje.
- 21.4 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të jenë persona fizikë, pa asnjë kufizim për sa i përket shtetësisë, dhe do të formohet në mënyrë të tillë që të arrijë përfaqësim të balancuar gjinor.
- 21.5 Pas përfundimit të emërimit fillestar, çdo emërim pasues i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës do të kryhet përmes një procedure të hapur dhe konkurruese, të organizuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve.
- 21.6 Këshilli Mbikëqyrës zgjedh nga radhët e anëtarëve të tij një Kryetar. Kryetari emërohet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe votues në një mbledhje të vlefshme të Këshillit Mbikëqyrës sipas nenit 23 të këtij Statuti.
- 21.7 Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës ka për detyrë të:
- thërrasë Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve dhe të drejtojë mbledhjet;
 - thërrasë Asamblesë e Përgjithshme të Aksionareve sipas pikës 22.2.14 të nenit 22 më poshtë në vijim të autorizimit nga mbledhja e Këshillit;
 - drejtojë mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës dhe të sigurojë zhvillimin e tyre në mënyrë të rregullt;
 - koordinojë veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës dhe të nxisë funksionimin efektiv të tij;
 - sigurojë që të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të informohen në kohë për çështjet që kërkojnë vendimmarrje të informuar;
 - përfaqësojë Këshillin Mbikëqyrës në marrëdhëniet me aksionarët dhe organet e tjera të Bankës, përveç rasteve kur kjo kompetencë i është deleguar një personi tjetër.

Neni 22

Roli dhe përgjegjësitë

- 22.1 Këshilli Mbikëqyrës ushtron kompetenca mbikëqyrëse dhe ka të drejtën të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e objektivave të Bankës, përveç kompetencave që i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve sipas legjislacionit në fuqi dhe këtij Statuti.
- 22.2 Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës përfshijnë, por nuk kufizohen në:
- 22.2.1 propozimin e statutit dhe ndryshimeve në të për miratim nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve;
 - 22.2.2 miratimin e strategjisë, të planit të biznesit e të produkteve kryesore;
 - 22.2.3 miratimin e strukturës organizative të Bankës Shqiptare të Zhvillimit sh.a.;
 - 22.2.4 miratimin e projekteve të investimeve dhe iniciativave të tjera të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve;

- 22.2.5 miratimin e politikës së menaxhimit të riskut financiar dhe likuiditetit për të siguruar stabilitetin financiar;
- 22.2.6 miratimin e akteve të tjera të nevojshme për mirëfunksionimin e Bankës dhe arritjen e objektivave;
- 22.2.7 përcaktimin e treguesve për mbikëqyrjen e performancës;
- 22.2.8 emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit;
- 22.2.9 përcaktimin e pagave e të shpërblimeve për anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe administratën;
- 22.2.10 krijimin e komitetit të riskut dhe komiteteve të tjera të brendshme;
- 22.2.11 përgatitjen, me kërkesë të Asamblesë se Përgjithshme të Aksionareve, për marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit dhe t'i rekomandojë Asamblesë se Përgjithshme të Aksionareve vendime të nevojshme për t'u marrë;
- 22.2.12 miratimin e propozimeve të bëra nga Këshilli i Administrimit për bashkëpunime tregtare afatgjata dhe propozime të politikave për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
- 22.2.13 miratimin e propozimeve të bëra nga Këshilli i Administrimit për marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të Bankës, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhi;
- 22.2.14 thirrjen e Asamblesë se Përgjithshme të Aksionareve, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e Bankës;
- 22.2.15 shqyrtimin dhe kontrollin e librave kontabël, dokumentet dhe aktivet e Bankës dhe kujdesin që Banka të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- 22.2.16 sigurimin se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme, të kryhen me saktësi nga organi administrimit;
- 22.2.17 sigurimin se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën 1 (një) herë në vit nga një auditues ligjor i pavarur, dhe raportin i auditimit, drejtuar Asamblesë se Përgjithshme të Aksionareve;
- 22.2.18 përcaktimin e strategjisë së riskut të Bankës dhe miratimin e kornizës dhe deklaratës së pranimit të rrezikut, duke përfshirë kufijtë maksimalë të ekspozimit ndaj një huamarrësi ose grupi huamarrësish të lidhur;
- 22.2.19 sigurimin që Banka të operojë sipas një kuadri të shëndoshë të menaxhimit të riskut dhe në një mënyrë të kujdesshme që mbron qëndrueshmërinë e saj financiare;

22.2.20 krijimin e bordeve këshillimore të ekspertëve me funksione mbështetëse strategjike dhe, kur është e nevojshme, përfshirjen e specialistëve të jashtëm, pa të drejta vote ose ndonjë kompetencë ekzekutive ose mbikëqyrëse;

22.2.21 çdo çështje tjetër e parashikuar nga legjislacioni në fuqi dhe Statuti.

22.3 Këshilli mund të krijojë nënkomitete të posaçme, të përbëra nga anëtarët e tij, për të përgatitur mbledhjet apo vendimet, apo për të zbatuar ose mbikëqyrur vënien në zbatim të vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës, si dhe për çështje apo adresimin e problematikave të veçanta që lidhen me mbarëvajtjen e punës së Bankës, sidomos ato të lidhura me veprimtarinë e administratës dhe auditimin e librave e të regjistrimeve kontabël. Sipas rastit, në komitete mund të marrin pjesë edhe zyrtarë të Bankës.

Neni 23

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

23.1 Këshilli Mbikëqyrës mblidhet me thirrjen e Kryetarit të tij, i cili gjithashtu në njoftimin e thirrjes përcakton, rendin e ditës, koordinon punimet dhe kujdeset që të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të informohen në mënyrë të përshtatshme mbi çështjet që do të trajtohen duke i vënë në dispozicion dhe materialet e nevojshme për çështjet që do të trajtohen në mbledhje.

23.2 Thirrja bëhet me anë të një njoftimi të dërguar të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, me çdo mjet të përshtatshëm që siguron provën e marrjes së tij, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes dhe, në rast urgjence, të paktën 3 (tre) ditë përpara. Njoftimi i thirrjes duhet të përmbajë datën, vendin dhe orën e mbledhjes, si dhe rendin e ditës. Përjashtimisht, mbledhja për emërimin e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës sipas pikës 21.6 të nenit 21 me sipër, thirret nga anëtari më i vjetër në moshë i Këshillit.

23.3 Këshilli Mbikëqyrës mblidhet në selinë e Bankës ose edhe në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

23.4 Mbledhjet dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës janë të vlefshme, edhe pa thirrje zyrtare, nëse marrin pjesë të gjithë anëtarët aktualë të tij.

23.5 Këshilli mblidhet rregullisht të paktën një herë në 3 (tre) muaj, si dhe sa herë që e kërkon interesi i Bankës.

23.6 Për vlefshmërinë e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të marra në mbledhje, kërkohet prania ose përfaqësimi i shumicës së anëtarëve në detyrë; vendimet merren me shumicë të thjeshtë të të pranishmëve. Në rast barazie votash, vota e Kryetarit ka vlerë të dyfishtë. Pjesëmarrja në mbledhje është personale dhe përfaqësimi i anëtarëve nuk lejohet në asnjë rast.

23.7 Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mund të zhvillohen edhe përmes audiokonference ose videokonference, me kusht që:

- a. Kryetari i Këshillit dhe sekretari i mbledhjes, i caktuar nga Kryetari dhe jashtë anëtarësisë së Këshillit, të jenë të pranishëm në të njëjtin vend dhe të përkujdesen për hartimin dhe nënshkrimin e procesverbalit, duke u konsideruar se mbledhja është zhvilluar në atë vend;
- b. t'i mundësohet Kryetarit të mbledhjes dhe sekretarit të verifikojnë identitetin e pjesëmarrësve, të drejtojnë zhvillimin e mbledhjes dhe të konstatojnë e shpallë rezultatet e votimit;
- c. t'i mundësohet sekretarit që harton procesverbalin të ndjekë në mënyrë të përshtatshme zhvillimin e mbledhjes që përshkruhet në procesverbal;
- d. pjesëmarrësve t'u mundësohet të marrin pjesë në diskutim dhe në votimin njëkohësisht për çështjet në rendin e ditës, si dhe të shohin, marrin ose dërgojnë dokumente.

23.8 Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës, brenda kufijve të lejuar nga ligji, mund të merren edhe nëpërmjet konsultimit me shkrim ose mbi bazën e pëlqimit të shprehur me shkrim, me kusht që:

- a. t'u garantohet të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës e drejta për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe t'u sigurohet atyre informacion i përshtatshëm dhe në kohë të përshtatshme;
- b. në dokumentet e nënshkruara nga anëtarët të pasqyrohen qartë çështjet objekt i vendimmarrjes dhe pëlqimi i shumicës së anëtarëve në detyrë;
- c. vendimet të regjistrohen pa vonesë në librin e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës dhe dokumentacioni përkatës të ruhet në arkivat e Bankës.

KREU VII

(KËSHILLI ADMINISTRIMIT – PËRBËRJA- ROLI DHE PËRGJEGJËSITË –MBLEDHJET)

Neni 24

Këshilli i Administrimit

24.1 Banka Shqiptare e Zhvillimit sh.a., administrohet nga Këshilli i Administrimit, i cili shërben si organi ekzekutiv i drejtimit të saj.

24.2 Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtën në çdo kohë të shkarkojë, tërësisht ose pjesërisht, Këshillin e Administrimit me vendim të marre me shumice të thjeshtë.

Neni 25

Përbërja e Këshillit të Administrimit

25.1 Këshilli i Administrimit përbëhet nga 1 (një) ose më shumë administratorë, por jo më shumë se 7 (shtatë) anëtarë, dhe emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës për një mandat deri në 3 (tre) vjet, me mundësi ripërtëritje.

- 25.2 Anëtarët e Këshillit të Administrimit duhet të jenë persona fizikë, pa asnjë kufizim për sa i përket shtetësisë, dhe do të formohet në mënyrë të tillë që të arrijë përfaqësim të balancuar gjinor.
- 25.3 Njëri prej administratorëve emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës në cilësinë e Administratorit të Përgjithshëm, i cili ushtron funksionet ekzekutive të Bankës në përputhje me Statutin, vendimet e organeve të saj dhe kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Përcaktimi i funksioneve të anëtarëve të Këshillit të Administrimit kryhet nga Këshilli Mbikëqyrës.
- 25.4 Përjashtimisht dhe deri në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, administratori i parë i Bankës, që do të ushtrojë detyrat e Administratorit të Përgjithshëm dhe funksionet e Këshillit të Administrimit, emërohet:
- Z. Silvio Pedrazzi, shtetas italian, i lindur më 26.11.1959, me NID F94126001C dhe mbajtës i pasaportës italiane me nr. YC4588630;
- 25.5 Anëtarët e Këshillit të Administrimit udhëhiqen nga standardet më të larta etike duke vepruar sipas parimit të mirëbesimit, të detyrimit për kujdesin, besnikërinë, konfidencialitetin, integritetin dhe pavarësinë në raport me Bankën.

Neni 26

Roli dhe përgjegjësitë

- 26.1 Këshilli i Administrimit është përgjegjës për administrimin e përditshëm dhe operacionet e Bankës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
- a. zbatimin e strategjive, të planeve të biznesit dhe politikave të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve dhe Këshilli Mbikëqyrës;
 - b. menaxhimin e burimeve, të financave dhe aktiviteteve operative, në përputhje me objektivat dhe kuadrin ligjor;
 - c. përfaqësimin në marrëdhëniet me palë të treta, i cili i rezervohet Administratorit të Përgjithshëm, përfshirë autoritetet shtetërore, palët e interesuara dhe entitete të tjera;
 - d. hartimin dhe dorëzimin e raporteve vjetore, pasqyrave financiare dhe vlerësimeve të performancës për Këshillin Mbikëqyrës;
 - e. propozimin e iniciativave të reja, projekteve të investimeve dhe politikave për miratim nga Këshilli Mbikëqyrës;
 - f. miratimin e projekteve të investimeve në përputhje me objektivat, strategjinë, planin e biznesit;
 - g. sigurimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregullat përkatëse, si dhe kontrollin e brendshëm në operacione;
 - h. menaxhimin e strukturave administrative të brendshme, duke përfshirë punësimin dhe mbikëqyrjen e stafit të Bankës;

- i. zbatimin e kuadrit të miratuar të menaxhimit të riskut, mbajtjen e sistemeve dhe kontrolleve të përshtatshme dhe raportimin te Këshillit Mbikëqyrës për çdo rrezik të rëndësishëm, shkelje të limiteve ose devijime nga pranimi i rrezikut;
- j. çdo çështje tjetër e parashikuar nga legjislacioni në fuqi dhe Statuti.

26.2 Këshilli i Administrimit mund, me vendim, të caktojë dhe të përcaktojë detyrat dhe kompetencat e anëtarëve të tij dhe të vendosë kufij monetarë dhe kufizime të tjera që rregullojnë ushtrimin e kompetencave të deleguara, të gjitha brenda kompetencave të përcaktuara nga ky Statut.

Neni 27

Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

- 27.1 Dispozitat e këtij Statuti që rregullojnë mënyrën e funksionimit, thirrjen, zhvillimin dhe marrjen e vendimeve nga Këshilli Mbikëqyrës, zbatohen, për sa janë të përshtatshme dhe në përputhje me rolin dhe kompetencat përkatëse, edhe për mbledhjet dhe funksionimin e Këshillit të Administrimit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe shprehimisht në këtë Statut.
- 27.2 Kompetencat e Këshillit të Administrimit ushtrohen nga Administratori i Përgjithshëm, për aq kohë sa nuk është emëruar Këshilli i Administrimit.

KREU VIII

(KOMITETI I KONTROLLIT DHE PËRBËRJA E TIJ– ROLI DHE PËRGJEGJËSITË)

Neni 28

Komiteti i Kontrollit dhe përbërja e tij

- 28.1 Komiteti i Kontrollit mbikëqyr raportimin financiar, kontrollet e brendshme dhe proceset e auditimit, dhe përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve për një periudhë deri në 3 (tre) vjet, nga të cilët kryetari i komitetit është anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, me të drejtë riemërimi.
- 28.2 Komiteti i Kontrollit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij mund të ndihmohet nga ekspertë të jashtëm të zgjedhur prej tij.

Neni 29

Roli dhe përgjegjësitë

- 29.1 Detyrat dhe kompetencat e Komitetit të Kontrollit përfshijnë:

- a. kontrollin dhe mbikëqyrjen e procedurave kontabël dhe kontrolleve të brendshme të Bankës, duke siguruar përputhshmërinë me legjislacionin dhe standardet, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre procedurave dhe kontrollin e llogarive e të regjistrave përkatës;
- b. rishikimin e raporteve të kontrollit të brendshëm dhe monitorimin e adresimit të rekomandimeve, që burojnë nga këto raporte;
- c. sigurimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe raportimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të Këshillit Mbikëqyrës;
- d. propozimin për emërimin e audituesit ligjor dhe realizimin e komunikimit ndërmjet tij dhe kontrollit të brendshëm;
- e. dhënien e mendimeve për Këshillin Mbikëqyrës për çështjet për të cilat është kërkuar një mendim;
- f. dhënien e rekomandimeve për veprime Këshillit Mbikëqyrës lidhur me raportet financiare dhe pasqyrat financiare.

29.2 Komiteti i Kontrollit mbledhet të paktën 3 (tre) herë në vit në mbledhje të zakonshme dhe mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme kur kërkohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

29.3 Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve; abstenimet nuk lejohen.

29.4 Procedurat, përgjegjësitë dhe metodat e funksionimit të Komitetit të Kontrollit përcaktohen në rregulloret e brendshme të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.

KREU IX

(KËRKESAT PËR PËRSHTATSHMËRI DHE AFTËSI – DISPOZITAT DETYRUESE)

Neni 30

Kërkesat për përshtatshmëri profesionale dhe aftësitë

30.1 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe të Këshillit të Administrimit, duhet të jenë persona që gëzojnë ndershmëri, integritet moral dhe plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a. kanë diplomë universitare ose pasuniversitare në fushat e financës, të ekonomisë ose të drejtësisë, si dhe kualifikime shtesë relevante në fushat e menaxhimit financiar, zhvillimit ekonomik ose qeverisjes së korporatave do të konsiderohen përparësi;
- b. kanë përvojë profesionale në çështje financiare dhe bankare, duke përfshirë menaxhimin e rrezikut, planifikimin strategjik, garantimin e kredive ose funksione të tjera kyçe të institucioneve të zhvillimit financiar;
- c. kanë të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) vjet përvojë profesionale në fushën specifike, sipas shkronjës “a” të këtij neni, duke përfshirë të paktën 5 (pesë) vjet në pozicione drejtuese në fushat e financës, të shërbimeve këshilluese ose të zhvillimit ekonomik.

Neni 31

Kriteret e integritetit dhe reputacionit

- 31.1 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Këshillit të Administrimit dhe mbajtësit e funksioneve kyçe në Bankë duhet të plotësojnë në çdo kohë kriteret e integritetit dhe reputacionit, të cilat garantojnë një administrim të shëndoshë dhe të kujdesshëm të Bankës dhe mbrojnë interesat e saj afatgjata.
- 31.2 Nuk mund të emërohet apo të qëndrojë në detyrë asnjë person që është nën hetim, akuzë ose gjykim për vepra penale që lidhen me pasuritë, krimin ekonomik, korrupsionin, pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.
- 31.3 Nuk mund të emërohet asnjë person që është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra të tilla penale apo që ka qenë subjekt i masave ndaluese apo sanksioneve administrative të natyrës së rëndë në fushën financiare apo të drejtimit të shoqërive tregtare.
- 31.4 Këshilli Mbikëqyrës kryen në mënyrë të vazhdueshme vlerësimin e integritetit dhe reputacionit të anëtarëve të organeve drejtuese dhe personave në funksione kyçe dhe merr masat e nevojshme për pezullimin ose zëvendësimin e tyre nëse këto kritere nuk plotësohen më.
- 31.5 Para emërimit dhe periodikisht gjatë ushtrimit të funksionit, çdo anëtar dhe mbajtës i funksioneve kyçe është i detyruar të dorëzojë një deklaratë të integritetit dhe reputacionit.

Neni 32

Kriteret e pavarësisë dhe konfliktit të interesit

- 32.1 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, Këshillit të Administrimit dhe drejtuesit ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe vetëm në interes të Bankës, të lirë nga çdo ndikim i jashtëm ose i brendshëm dhe në përputhje me parimet e këtij Statuti, dhe legjislacionit në fuqi që rregullon parandalimin e konfliktit të interesit.
- 32.2 Nuk mund të emërohet apo të ushtrojë funksione drejtimi ndonjë person që mban funksione politike ose nuk mbajnë funksion drejtues në shërbimin publik.
- 32.3 Banka miraton dhe zbaton një rregullore për menaxhimin e konfliktit të interesit, e cila përcakton mënyrat e identifikimit, parandalimit dhe menaxhimit të situatave të konfliktit aktual ose potencial të interesit për organet drejtuese dhe funksionet kyçe.
- 32.4 Banka mban një regjistër të konflikteve të interesit, i cili administrohet nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore dhe përditësohet me çdo deklaratë të dorëzuar. Ky regjistër i raportohet periodikisht Këshillit Mbikëqyrës dhe auditohet sipas procedurave të brendshme të kontrollit.

Neni 33

Dispozitat detyruese

- 33.1 Çdo person fizik ose juridik që zotëron aksione në Bankë (në vijim “Aksionari i Ri”), me vetë faktin e zotërimit të aksioneve dhe marrjes së statusit të aksionarit të Bankës, pranon në mënyrë të pakushtëzuar

të jetë i detyruar nga dispozitat e neneve 2, 3, 9.3, 11, 13, dhe 36.4 të këtij Statuti (në vijim “Dispozitat Detyruese”).

33.2 Aksionari i Ri pranon dhe njeh shprehimisht se Dispozitat Detyruese përbëjnë elementë thelbësorë të qeverisjes, qëllimit dhe stabilitetit afatgjatë të Bankës dhe janë në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e saj. Për rrjedhojë, pavarësisht përqindjes së zotërimit të aksioneve, individualisht apo së bashku me të tjerë, Aksionari i Ri angazhohet të mos propozojë, të mos votojë pro dhe të mos mbështesë në asnjë mënyrë ndonjë ndryshim, shfuqizim apo devijim nga Dispozitat Detyruese, drejtpërdrejt apo tërthorazi.

33.3 Ky angazhim është i detyrueshëm edhe për çdo pasardhës, përfitues apo subjekt të mëvonshëm që i kalojnë aksionet fillimisht të zotëruara nga Aksionari i Ri, dhe mbetet në fuqi edhe pas kalimit të tyre.

33.4 Çdo zotërim aksionesh në Bankë do të konsiderohet si pranimi i plotë i kushteve të mësipërme të këtij neni.

KREU X

(AUDITUESI LIGJOR/EKSPERTI KONTABËL – VITI FINANCIAR – LIKUIDIMI DHE FALIMENTIMI- LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE)

Neni 34

Audituesi ligjor

34.1 Audituesi i parë ligjor i Bankës është shoqëria “Forvis Mazars” sh.p.k, me NIPT K32123006W, me adresë: Njësia Bashakiake Nr. 5, Rruga “Emin Duraku”, Pallati Binjakët Nr. 5, Kati 1 teknik, Ap. 1&2, Tiranë.

34.2 Audituesi i ligjor do të emërohet për një mandat të rinovueshëm prej 1 (një) viti, i nënshtuar një rotacioni të detyrueshëm pas përfundimit të çdo periudhe 1-vjeçare.

34.3 Eksperti i parë Kontabël është Z. Teit Gjini, lindur në 08.01.1970, në Elbasan Shqipëri, me nr personal identifikimi H0010811F.

Neni 35

Viti financiar

35.1 Viti financiar i Bankës fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

35.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Bankës Shqiptare të Zhvillimit Sh.A, në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 dhjetor të po atij viti.

Neni 36

Likuidimi dhe falimentimi

- 36.1 Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve merr vendim për prishjen e Bankës dhe hapjen procedurave të likuidimit.
- 36.2 Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve do të emërojë një ose më shumë likuidues, duke përcaktuar kompetencat e tyre në përputhje me ligjin në fuqi.
- 36.3 Banka do të vazhdojë të ekzistojë si njësi juridike vetëm për qëllime të likuidimit, deri në përfundimin e procedurës. Gjatë kësaj periudhe, emërtimit të Shoqërisë duhet t'i shtohet shënimi “në likuidim”.
- 36.4 Banka Shqiptare e Zhvillimit Sh.A, nuk është subjekt i procedurave të falimentimit. Ky proces rregullohet me ligj të posaçëm.

Neni 37

Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 37.1 Ky Statut bazohet në legjislacionin shqiptar, dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimimi i tij i referohen legjislacionit shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 23, datë 17.3.2025 “Për Bankën Shqiptare të Zhvillimit” dhe ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.
- 37.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin ose interpretimin e këtij Statuti, si dhe çdo konflikt ndërmjet Bankës dhe aksionareve, ose ndërmjet vetë aksionareve, do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë.

Ky akt është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe me datë 16.12.2025.

AKSIONARI THEMELUES I VETËM

MINISTRI PËR FINANÇAT

Bëtrit Malaj

